



“Nuk ka permbushur detyrimet del edhe na flet per nje super skuader”, keto jane fjalet e Cim Babasit, sponsorit te Tiranes pas largimit. Ai akuzon Refik Halilin se nuk ka dhene shumen qe u zotua para kryetarit Basha se do te jepte cdo muaj. “Ai bashke me njerezit qe l qendrojne afer beri te pamunduren per te me penguar mua te beja nje pune te mire me Tiranen. Nuk dha ato para qe duhet te jepte dhe une shpenzimet i kam mbuluar vete. Do ta shohim tani se cfare do te bej por ju siguroj se nuk eshte ai qe hiqet”, ka deklaruar Cim Babasi pas largimit per Refik Halilin.